



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 26, datë 24.11.2021

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT ZHVILLUES TË OBJEKTIT:
“GODINË 4 KATE, ME 2 KATE NËNTOKË, ME TARRACË TË SHFRYTËZUESHME TË
GJELBËRUAR, ME FUNKSION HOTELERI DHE SHËRBIME TURISTIKE”,
NË RRUGËN VLORË - ORIKUM, BASHKIA VLORË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 13, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Z. Adrian Resuli, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues të objektit “Godinë 4 kate, me 2 kate nëntokë, me tarracë të shfrytëzueshme të gjelbëruar, me funksion hoteleri dhe shërbime turistike”, në rrugën Vlorë - Orikum, Bashkia Vlorë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 23, datë 28.07.2020, nga Adrian Resuli në shoqërinë “Belvedere 2021” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

